



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**POSTA SHQIPTARE SH.A**  
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**  
**DREJTORIA LIGJORE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

**Datë 24.06.2026**

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik I.S.S (Integrated Smart Solutions), sh.p.k**

**NIPT L92230027U**

**Me adresë: : Rruga e “Kavajës”, Kompleksi “Square 21”, sh.2, k.9 Tiranë,.**

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

\* \* \*

**Tipi i Kontratës: Shërbim**

**Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”;**

**Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF -79524-03-18-2026;**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a”, me fond limit 39,326,900 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind) lekë, pa TVSH;**

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 05.05.2026;

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit. Buletini Datë 11.05.2026, nr. 31;

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim  X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: **“Eurogjici-Security” NIPT K31929010K**, dhe **“Instant.al” NIPT L81506043D**, kanë paraqitur ofertën ekonomike me vlerë **34,732,500** (tridhjetë e katër milion e shtëtëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) Lekë pa T.V.SH.

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**  X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik: **I.S.S (Integrated Smart Solutions) NIPT-i L92230027U**, ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë **38.923,000** (tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë) Lekë pa T.V.SH.

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**  X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori ekonomik: **“Entech.al”, NIPT-i L92201032D**, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**  X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Eurogjici-Security” NIPT K31929010K**, dhe **“Instant.al” NIPT L81506043D**, kanë paraqitur ofertën ekonomike me vlerë **34,732,500** (tridhjetë e katër milion e shtëtëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) Lekë pa T.V.SH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të ofertës së paraqitur në tender rezulton se **Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet:**

- **Nuk plotëson pikën 2.3.2 të Kriterve të Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ku është kërkuar ;**

Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve se ka jo më pak se 10 persona të punësuar për 3-Muajt e fundit (Janar, Shkurt Mars) të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025. në të cilën të përfshihen :

- (a) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) **Inxhinier elektronik ose ekuivalent**, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojë në listpagesa për 3-muajt e fundit (Janar, Shkurt Mars).
- (b) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) **specialist TIK/Informatike** (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) **ose ekuivalent**, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojë në listpagesa për 3-muajt e fundit (Janar, Shkurt Mars).
- (c) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) **Inxhinier Telekomunikacioni ose ekuivalent**, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figurojë në listpagesa për 3-muajt e fundit (Janar, Shkurt Mars).
- (d) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 3 (tre) punonjës të deklaruar si **montues të pajisjeve elektronike** ose profesioneve ekuivalente. Për këtë OE duhet të paraqesi një deklaratë me emrat e tyre dhe duhet të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi sipas formatit E-sig. për periudhën e 3-muajve të fundit (Janar, Shkurt Mars) sipas kodit përkatës të profesionit referuar VKM 514 datë 20.09.2017.

***Sqarim!*** *Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime për të përmbushur kriterin më sipër.*

Në formularin e vetëdeklarimit Z. Agim Zoti është deklaruar edhe si inxhinier elektronik edhe si montues i pajisjeve elektronike. Referuar listëpagesës rezulton se është montues i pajisjeve elektronike jo inxhinier.

Për sa më sipër, rezulton se Eurogjici sh.p.k i cili bazuar në marrëveshjen e bashkimit të operatorëve ekonomik ka marrë përsipër 92.5% të realizimit të shërbimeve do të vërë në dispozicion vetëm 1 montues të pajisjeve elektronike të deklaruar në mënyrë të pasaktë 2 herë dhe 2 punonjës të certifikuar për sistemet e alarmit. Instant. Al do të vërë në dispozicion 2 montues të pajisjeve elektronike duke u mbështetur në kapacitetet e subjektit Laviva Technologies, 3 inxhinierët e kërkuar , 2 persona të trajnuar nga prodhues të ndryshëm për sisteme cctv dhe 1 person te trajnuar për sisteme GPS edhe pse ka marrë përsipër vetëm 7.5% të objektit të prokurimit.

Në zbatim të Nenit 88, pika 3 të VKM për Rregullat e Prokurimit Publik ku përcaktohet se :

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim** apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Kjo kërkesë nuk përmbushet nga Eurogjici shpk në cilësinë e anëtarit me 92.5 % të marrë përsipër**

- **Nuk plotëson pikën 2.3.3 të Kriterve të Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ku është kërkuar ;**

**2.3.3** Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet të ketë si pjesë të stafit të punësuar për 3-Muajt e fundit (Janar, Shkurt Mars) të paktën:

- (a) **2 (dy)** punonjës të certifikuar nga kompani të ndryshme prodhuese të pajisjeve GPS ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre e vertetuar me certifikatat perkatëse dhe të figurojnë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën e 3 muajve të fundit (Janar,Shkurt Mars).
- (b) **2 (dy)** punonjës të certifikuar nga kompani të ndryshme prodhuese të pajisjeve të sistemeve të alarmit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre e vertetuar me certifikatat përkatëse dhe të figurojnë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën e 3 muajve të fundit (Janar,Shkurt Mars) .
- (c) **2 (dy)** punonjës të certifikuar nga kompani të ndryshme prodhuese të sistemeve të vëzhgimit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre e vertetuar me certifikatat përkatëse dhe të figurojnë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën e 3 muajve të fundit (Janar,Shkurt Mars) .

Në dokumentat e paraqitura në përmbushje të pikës a) Rezulton se Eurogjici shpk nuk ka deklaruar **asnjë punonjes të trajnuar për pajisje GPS.**

Instant.al ka deklaruar vetem **një** punonjës të trajnuar për GPS z. Granit Gjana për rrjedhojë ky kriter nuk përmbushet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik **“Instant.AL” sh.p.k.** ka paraqitur një marrëveshje bashkëpunimi me subjektin e tretë **“LA VIVA TECHNOLOGIES” sh.p.k.**, sipas së cilës ky i fundit angazhohet të mbështesë operatorin me kapacitete teknike dhe njerëzore.

Në vijim të kësaj marrëveshjeje, subjekti mbështetës ka paraqitur gjithashtu një formular vetëdeklarimi, në të cilin deklaron se do të vërë në dispozicion **2 (dy) punonjës me profil montues të pajisjeve elektronike.**

Megjithatë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se:

- Marrëveshja e bashkëpunimit ka karakter të përgjithshëm dhe nuk përcakton në mënyrë të detajuar dhe të detyrueshme kapacitetet konkrete që do të vihen në dispozicion për realizimin e kontratës;

- Deklarimi për 2 punonjës nuk shoqërohet me dokumentacion provues (kontrata pune, listëpagesa E-sig, etj.) që të vërtetojë punësimin dhe disponueshmërinë reale të tyre gjatë periudhës së kërkuar;
  - Numri dhe profili i stafit të ofruar nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit për kapacitetin njerëzor;
  - Mbështetja i atribuohet operatorit “Instant.AL” sh.p.k., i cili ka një përqindje minimale pjesëmarrjeje në kontratë, ndërkohë që operatori kryesor nuk përmbush vetë kapacitetet e kërkuara;
  - Referuar nenit 88, pika 3 të VKM nr. 285/2021, kapacitetet duhet të përmbushen në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës, çka në këtë rast nuk rezulton e provuar.
- **Nuk plotëson pikën 2.3.4 të Kriterve të Veçanta të Kualifikimit, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ku është kërkuar ;**

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të sigurojë AK që merr persiper mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese: Kamerat Hikvision, Sistemet e Alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack dhe implementimin e tyre në platformën e menaxhimit.

Gjithashtu platformat që përdor Posta Shqiptare për menaxhimin e këtyre sistemeve janë :

- Platforma për menaxhimin e sistemeve të kamerave është Hikcentral
- Platforma për menaxhimin e sistemeve të alarmit është Kronos NET

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë suporti nga Prodhuesit ose Distributorët e Autorizuar të Sistemeve të mësipërme për periudhën 1-vjeçare të mirëmbajtjes.

O.E merr persiper që do të suportoje AK për mirëmbajtjen e këtyre platformave dhe nderhyrjen për zgjidhjen e problemeve në rast të një avarie të mundshme Brenda 6 orësh nga njoftimi.

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur një Autorizim Distributori nga SSD sh.pk që i referohet produkteve : Dahua, Teletek dhe Ajax që nuk janë pjesë e listës së sistemeve ekzistuese të AK për të cilat kërkohet mirëmbajtja.

**SSD shpk nuk ka marrë përsipër të ofrojë suportin për Kamerat Hikvision, Sistemet e Alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack.**

Për sistemet GPS nuk është paraqitur një deklaratë suporti apo platforma e menaxhimit që do të ofrohet.

Gjithashtu referuar kriterit të sipërcituar vërehet se Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur asnjë nga Zgjidhjet teknike të kërkuara në Specifikimet Teknike që janë thelbësore për realizimin e shërbimëve të mirëmbajtjes.

**Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, rezulton që oferta e më sipërme nuk kualifikohet.**

2. Operatori ekonomik: “Entech.al”, NIPT-i L92201032D, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, rezulton që mos paraqitja e asnjë dokumentacioni dhe oferte ekonomike sjell skualifikimin e operatorit ekonomik

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **I.S.S (Integrated Smart Solutions) sh.p.k**, me Nipt **L92230027U**, me adresë: **Rruga e “Kavajës”, Kompleksi “Square 21”, sh.2, k.9 Tiranë**, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **38.923,000 (tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e njëzet e tre mijë)** lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a.**, Adr.: **Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO    X                       JO

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike është paraqitur ankesa e **Bashkimit të Operatorëve Ekonomik: “Eurogjici-Security” NIPT K31929010K**, dhe **“Instant.al” NIPT L81506043D** me nr. 121 prot., datë 12.05.2026

**Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 779/2026, datë 10.06.2026 ka vendosur të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka rivlerësuar Bashkimin e Operatorëve ekonomik “Eurogjici-Security”, dhe “Instant.al”, pas rivlerësimit si dhe në mbështetje të vendimit nr. 831/2026, datë 18.06.2026 Komisioni i Prokurimit Publik ka lejuar Autoritetin Kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
Etjen Xhafaj**

**ME AUTORIZIM  
DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË  
ADMINISTRIMIT  
Elion Semanaj**